



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail..contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 si dhe Ligjit nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, si edhe në bazë të nenit 23 dhe 26 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë: **05.07.2021**, mori vendim të **ri publikojë**:

K O N K U R S I N PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës

1. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale:

Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);

Të posedojë së paku pesë (5)vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;

Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;

Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;

Provimi i jurisprudencës;

Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

Shërben si sekretar i Bordit të Drejtorëve dhe është pikë qendrore eKomunikimit me Komisionin Komunal të Aksionarëve mbi funksionimin eNdërmarrjes“Termokos”;

Të sigurojë përcjelljen e proceduravenga Bordi, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, komiteteve të Bordit dhe aksionarëve dhe në bashkëpunim me Kryesuesin e Bordit bënë përgatitjen dhe shpërndarjen e rendit të ditës;

Të mbajë procesverbalin e takimeve dhe t’ishpërndajë ato tek drejtorët dhe Komisioni Komunal i Aksionarëve;

Të mbajë procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe t’i regjistrojë ato në librin e protokollit;

Vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve, të bëjë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit, komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;

Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të Korporatës duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve të Bordit dhe duhet të sigurojë, që ato përputhen me procedurat e Bordit.

Mirëmban regjistrin e të dhënave të ndërmarrjes;

Përcjell ndryshimet ligjore, që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë;

Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse, siç mund të kërkohet me Ligjin për ndërmarrjet publike ose nga statuti i ndërmarrjes;

Koordinon me KE përgatitjen e letrave (dokumenteve) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;

Merret me çështjet tjera të qeverisjes së ndërmarrjes sipas nevojës.

3. Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

Formulari i aplikimit;

CV;

Letër motivimi;

Dëshmi mbi kualifikimin profesional;

Dëshmi mbi përvojën e punës dhe shkollimin;

Certifikatë që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre muaj);

Kopje e letërnjoftimit;

Deklarata nën betim;

Lista e dokumenteve të dorëzuara.

Të interesuarit mund t’i dorëzojnë aplikacionet e tyre me dokumentet tjera relevante në arkivin e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë, Rr. Luan Haradinaj p.n., Prishtinë, duke filluar nga data **07.07.2021 deri me datën 06.08.2021**, çdo ditë pune prej orës 8:30 – 15:30, të adresuara për: “Bordin e Drejtorëve” të N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.

Formulari për aplikim, Lista e Dokumenteve të dorëzuara dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyret e Ndërmarrjes.